Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet e mbledhjeve të tetë (8) dhe të nëntë (9) të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 08/L-021 për Tregti me Jashtë, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe duke marrë parasysh Vendimin 2025/02/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, të datës 18 dhjetor 2025, në rastin ECS-02/21, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndalohet tregtimi i energjisë elektrike, me ndërmarrjet e identifikuara në Listën sipas pikës 2 të këtij Vendimi, duke përfshirë blerjen, shitjen, importin dhe eksportin e energjisë elektrike, drejtpërdrejt ose përmes tranzitit ose rishitjes, në një apo më shumë shtete të treta.

2. Obligohet Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) që brenda afatit ligjor, në bazë të të dhënave të regjistrimit të bizneseve, përfshirë të dhënat për pronësinë dhe pronarët përfitues, t'i identifikojë ndërmarrjet e regjistruara me veprimtari kryesore ose dytësore në sektorin e energjisë elektrike. Ky identifikim do të përfshijë kategoritë e mëposhtme të ndërmarrjeve:

   2.1. kanë ndërmarrje amë, të drejtpërdrejtë ose përfundimtare, të regjistruar në Serbi;
   2.2. janë degë ose njësi organizative të ndërmarrjeve të regjistruara në Serbi;
   2.3. kanë lidhje direkte apo indirekte me persona fizikë ose persona juridikë të regjistruar në Serbi.

3. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh.A., sipas legjislacionit në fuqi dhe brenda afatit ligjor, identifikojnë ndërmarrjet, përkatësisht pjesëmarrësit e regjistruar në tregun e energjisë elektrike, që përfshihen në kategoritë e pikës 2.

4. Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, Zyra e Rregullatorit për Energji dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut, pas përfundimit të identifikimit të ndërmarrjeve sipas pikës 2 të këtij Vendimi, ia përcjellin listën dhe të dhënat përkatëse Ministrisë së Ekonomisë.

5. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut, në kuadër të përgjegjësive dhe kompetencave të tij ligjore, ndërmerr veprimet e nevojshme për zbatimin e kufizimit të përcaktuar në pikën 1. të këtij Vendimi.

6. Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në kuadër të kompetencave ligjore të monitorimit të tregut të energjisë elektrike, siguron se masat e këtij Vendimi po zbatohen nga të gjitha ndërmarrjet e licencuara, përfshirë edhe ato të cilat janë të liruara nga procesi i licencimit sipas marrëveshjeve bilaterale.

7. Përjashtimisht, ndalimi i përcaktuar me këtë Vendim nuk zbatohet për transaksionet dhe aktivitetet e tregtimit të energjisë elektrike, që burojnë nga Marrëveshja e Brukselit për Energjinë e vitit 2013, Konkluzionet e Lehtësuesit të Bashkimit Evropian për Zbatimin e Marrëveshjes për Energjinë të vitit 2013, të datës 25 gusht 2015, si dhe Udhërrëfyesi për Zbatimin e Marrëveshjeve për Energjinë, i datës 21 qershor 2022.

8. Ministria e Ekonomisë monitoron zhvillimet lidhur me eliminimin e pengesave ndaj tregtisë komerciale ndërkufitare të energjisë elektrike dhe e informon Qeverinë për çdo ndryshim relevant të rrethanave që kanë shërbyer si bazë për marrjen e këtij Vendimi.

9. Në rast se rrethanat që kanë shërbyer si bazë për marrjen e këtij Vendimi nuk ndryshojnë deri më 28 shkurt 2027, Ministria e Ekonomisë do t'i propozojë Qeverisë masa të tjera gjithëpërfshirëse.

10. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 25, paragrafët 1.2. dhe 1.4, të Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M
Për masat e emergjencës për furnizimin e energjisë

1. Shpallen masat emergjente për furnizimin me energji, të vlefshme për periudhën prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi.

2. Detyrohet ndërmarrja hidro-ekonomike "Ibër-Lepenci" (IL) të prodhojë energji nga HC "Ujmani", për qëllime të furnizimit me energji për konsumatorët me të drejtë të shërbimit universal.

3. Ndërmarrja hidro-ekonomike "Ibër-Lepenci" do të realizojë prodhimin nga objektet e prodhimit, të cekura sipas udhëzimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT).

4. Obligohet Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut që të udhëzojë "Ibër-Lepencin" të prodhojë, për aq sa është e mundur teknikisht, gjatë kohëve të pikut dhe në secilin rast në kohën kur prodhimi i tyre ndikon më së shumti në uljen e kostove të sistemit, apo për arsye të sigurisë së furnizimit.

5. Obligohet Furnizuesi për Shërbim Universal të kompensojë ndërmarrjen hidro-ekonomike "Ibër-Lepenci" për prodhimin e energjisë, në përputhje me çmimin referent të Rregullatorit të Energjisë.

6. Ministria e Ekonomisë themelon dhe udhëheq Komitetin Teknik Emergjent, të përbërë nga përfaqësuesit e institucioneve dhe të ndërmarrjeve relevante.

7. Obligohet Komiteti Teknik Emergjent që të rekomandojë masa shtesë, përfshirë edhe kushte të veçanta komerciale, për ta menaxhuar situatën emergjente të furnizimit me energji elektrike.

8. Obligohet Komiteti Teknik Emergjent të monitorojë dhe të raportojë çdo dy javë te Ministria e Ekonomisë, për gjendjen e përgjithshme të sigurisë së furnizimit, duke përfshirë disponueshmërinë e kapaciteteve gjeneruese, furnizimin, kërkesën dhe rrjetin e energjisë elektrike në vend.

9. Obligohen të gjitha institucionet publike të marrin masa në kursimin e energjisë elektrike.

10. Qeveria e Republikës së Kosovës do të ndërmarrë edhe masa të tjera të veçanta, në përputhje me nevojat që mund të paraqiten.

11. Vendimi hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet menjëherë.

12. Ky vendim i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim brenda 3 ditëve.

A r s y e t i m

Qeveria e Republikës së Kosovës merr vendim për shpalljen e masave emergjente në furnizimin me energji elektrike, duke marrë parasysh rrethanat e krijuara që kanë ndikuar në sigurinë e furnizimit në vend. Në veçanti, sektori i energjisë po përballet me çmime të larta të importit të energjisë elektrike. Këto zhvillime ndërlidhen, me paqëndrueshmërinë e tregjeve ndërkombëtare të energjisë, si pasojë e konfliktit në Iran dhe ndërprerjeve të qarkullimit përmes Ngushticës së Hormuzit, të cilat kanë ndikuar në tregjet globale të naftës dhe gazit natyror, duke ushtruar presion mbi çmimet e energjisë elektrike edhe në tregjet evropiane dhe rajonale, përfshirë ato nga të cilat furnizohet Republika e Kosovës.

Siguria e furnizimit me energji elektrike, gjithashtu, ndikohet nga mosoperimi i njësisë B1 të Termocentralit "Kosova B" të Korporatës Energjetike të Kosovës, si pasojë e punimeve në kuadër të projektit për instalimin e elektrofiltrave të rinj dhe sistemit për reduktimin e oksideve të azotit (NOx), të financuar dhe të kontraktuar nga Bashkimi Evropian. Vonesat në realizimin e këtij projekti dhe paqartësia lidhur me afatin e rikthimit të njësisë B1 në operim, kanë ndikuar në bilancin energjetik, i cili kishte paraparë rikthimin e saj në operim më 25 nëntor 2026, rrisin rrezikun për sigurinë e furnizimit gjatë sezonit dimëror.

Për më tepër, Serbia ka vazhduar të bllokojë funksionalizimin komercial të kapaciteteve ndërkufitare, duke kufizuar nivelin e importeve që sektori i energjisë mund ta tregtojë për siguri të furnizimit, duke ndikuar kështu në rritjen e mëtejshme të çmimeve të importit. Pavarësisht Vendimeve të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë që konstatojnë se ky veprim i operatorit të transmisionit të Serbisë përbën shkelje të obligimeve ndërkombëtare, linja ndërkufitare ngelet e pashfrytëzueshme.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

Për vendosjen e obligimit të shërbimit publik ndaj KEK-ut për sigurimin e kapaciteteve ndërkufitare të transmisionit

1. Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.A. (KEK) i vendoset obligimi i shërbimit publik për sigurimin e kapaciteteve ndërkufitare të transmetimit, në funksion të adresimit të mungesës së prodhimit të planifikuar nga njësia B1 e Termocentralit "Kosova B", gjatë periudhës së përcaktuar në pikën 3. të këtij Vendimi.

2. Obligimi sipas pikës 1. kufizohet në sigurimin e të drejtave të përdorimit të kapaciteteve ndërkufitare, përmes mekanizmave të zbatueshëm të alokimit dhe në përputhje me rregullat e tregut dhe të operatorëve përkatës të sistemit të transmetimit.

3. Sigurimin i kapaciteteve ndërkufitare duhet të mbulojë periudhën nga 1 dhjetori 2026 deri më 31 dhjetor 2026.

4. Korporata Energjetike e Kosovës i ndërmerr veprimet e arsyeshme t'i sigurojë kapacitetet ndërkufitare, duke marrë parasysh nevojat e dokumentuara për sigurinë e furnizimit dhe disponueshmërinë e kapaciteteve.

5. Korporata Energjetike e Kosovës mban evidencë të veçantë për kapacitetet e siguruara, pagesat dhe shpenzimet e tjera, të lidhura drejtpërdrejt me sigurimin e këtyre kapaciteteve, si dhe i raporton Ministrisë së Ekonomisë për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Kostot neto të arsyeshme dhe të verifikuara që rezultojnë nga përmbushja e këtij obligimi, do të kompensohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Vendim i përcillet Zyrës së Rregullatorit për Energji, Korporatës Energjetike të Kosovës, Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut, Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Financave për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse sipas Ligjit për Energjinë Elektrike.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Siguria e furnizimit me energji elektrike gjatë sezonit dimëror 2026/2027 është prioritet i institucioneve të Republikës së Kosovës. Njësia B1 e Termocentralit "Kosova B" është jashtë operimit për shkak të punimeve të projektit për elektrofiltra dhe reduktimin e NOx, i financuar nga Bashkimi Evropian, dhe vonesat në këto punime krijojnë pasiguri për kthimin e saj në operim në kohë, çka pritet të rrisë nevojën për import në periudhën e konsumit më të lartë. Prandaj, Qeveria vlerëson se ekziston interes publik për vendosjen e një obligimi të përkohshëm të shërbimit publik ndaj KEK-ut, sipas nenit 5, paragrafi 1.1., të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, për sigurimin e kapaciteteve ndërkufitare të nevojshme për importin e energjisë elektrike nga 1 dhjetori 2026 deri më 31 dhjetor 2026. Masa është e domosdoshme, sepse mbështetja vetëm te blerjet afatshkurtra rrit rrezikun e mungesës dhe të kostove të jashtëzakonshme, dhe është proporcionale e më së paku kufizuese, pasi zbatohet vetëm për një periudhë të caktuar dhe për sasitë e nevojshme për mbulimin e prodhimit të munguar të B1, përmes mekanizmave ekzistues të tregut dhe pa të drejta ekskluzive për KEK-un. Kostot neto të arsyeshme dhe të verifikuara që rezultojnë nga përmbushja e këtij obligimi do të kompensohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërsa Zyra e Rregullatorit për Energji e përfshin obligimin në licencën e KEK-ut dhe mbikëqyr zbatimin e tij.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Konventës për Marrëveshjen për Zgjedhjen e Gjykatës.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e "Konventës së Lubjanës - Hagës për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Hetimin dhe Ndjekjen Penale të Krimit të Gjenocidit, Krimeve kundër Njerëzimit, Krimeve të Luftës dhe Krimeve të tjera Ndërkombëtare".

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Konventës për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore të Huaja në Çështjet Civile apo Tregtare.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Protokollit për ndryshimin e Marrëveshjes mbi statusin dhe funksionet e Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes mbi Ekstradimin ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Franceze.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Franceze.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhënëse të Agjencive Ekzekutive.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-216 mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-133.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji Kundër Dukurive Negative në Sport.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 08/2021 për Emergjencat dhe Monitorimin Radiologjik.

2. Obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 43 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i Vlerësimit Ex-Post i Ligjit Nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

2. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit që, në bazë të gjetjeve dhe rekomandimeve të Raportit të përcaktuar në pikën 1. të këtij Vendimi, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, ta përditësojë Programin e Projektligjeve.

3. Raporti i Vlerësimit Ex-Post të Ligjit Nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin e Projektligjeve, të përditësuar sipas pikës 2. të këtij Vendimi, t'ia përcjellë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafi 2, dhe të nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 15/158 të Qeverisë, të datës 29 nëntor 2013

1. Ndryshohet dhe plotësohet Aneksi 1. i Vendimit Nr. 15/158, të datës 29 nëntor 2013, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në raport me shtetasit e Belizesë, për të cilët vendoset regjimi i vizave për hyrje në Republikën e Kosovës.

2. Aneksi 1. i përditësuar dhe i konsoliduar, i cili përfshin ndryshimet sipas pikës 1. të këtij Vendimi, si dhe harmonizimet terminologjike, është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

3. Pikat e tjera të Vendimit Nr. 15/158 të Qeverisë, të datës 29 nëntor 2013, mbeten të pandryshuara.

4. Obligohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës dhe institucionet e tjera relevante për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

ANEKSI 1
LISTA E SHTETEVE PA REGJIM TË VIZAVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

	LISTA E SHTETEVE PA REGJIM TË VIZAVE
1.	Antigua dhe Barbuda
2.	Argjentina
3.	Australia
4.	Bahamet
5.	Bahreini
6.	Barbadosi
7.	Brunei
8.	Bullgaria*
9.	Dominika
10.	Luksemburgu*
11.	El Salvadori
12.	Emiratet e Bashkuara Arabe
13.	Mikronezia
14.	Bosnja dhe Hercegovina
15.	Hungaria*
16.	Grenada
17.	Guajana
18.	Guatemala
19.	Greqia*
20.	Ishujt Marshall
21.	Sejshelet
22.	Ishujt Solomon
23.	Japonia
24.	Katari
25.	Kanadaja
26.	Kiribati
27.	Kolumbia
28.	Zvicra*
29.	Kuvajti
30.	Letonia*
31.	Lesoto
32.	Lituania*
33.	Malajzia
34.	Maldivet
35.	Mali i Zi
36.	Arabia Saudite
37.	Mbretëria e Bashkuar
38.	Belgjika*

*Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe shtetet anëtare të zonës *Schengen*.

39.	Danimarka*
40.	Jordania
41.	Holanda*
42.	Norvegjia*
43.	Spanja*
44.	Suedia*
45.	Meksika
46.	Mauritiusi
47.	Nauru
48.	Nikaragua
49.	Omani
50.	Palau
51.	Panamaja
52.	Papua Guineja e Re
53.	Paraguai
54.	Polonia*
55.	Portugalia*
56.	Andora
57.	Lihtenshtajni*
58.	Malta*
59.	Monako*
60.	Austria*
61.	Estonia*
62.	Çekia*
63.	Finlanda*
64.	Franca*
65.	Brazili
66.	Gjermania*
67.	Hondurasi
68.	Irlanda*
69.	Islanda*
70.	Italia*
71.	Kili
72.	Kostarika
73.	Koreja e Jugut
74.	Kroacia*
75.	Maqedonia e Veriut
76.	Qiproja*
77.	San Marino*
78.	Serbia
79.	Sllovakia*
80.	Sllovenia*
81.	Shqipëria

*Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe shtetet anëtare të zonës *Schengen*.

82.	Turqia
83.	Rumania*
84.	Shën Kits dhe Nevis
85.	Shën Luçia
86.	Shën Vinsenti dhe Grenadinet
87.	Samoa
88.	Sao Tome dhe Principe
89.	Selia e Shenjtë*
90.	Singapori
91.	Esvatini
92.	Izraeli
93.	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
94.	Timori Lindor
95.	Tonga
96.	Trinidad dhe Tobago
97.	Tuvalu
98.	Uruguai
99.	Venezuela
100.	Vanuatu
101.	Zelanda e Re
102.	Malavi

*Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe shtetet anëtare të zonës *Schengen*.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 24, paragrafët 1 dhe 4, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për ndarjen e mjeteve buxhetore, në shumën prej 1,375,726.22€ (një milion e treqind e shtatëdhjetepesë mijë e shtatëqindenjëzetegjashtë euro e njëzetedy centë), për realizimin e projektit "Nxitja dhe Levimi i Mundësive për Sigurinë e Ujit", përmes Klauzolës së Investimeve (fondi burimor 06), me qëllim të përmbushjes së obligimeve financiare që rrjedhin nga punët e realizuara, në përputhje me dinamikën e zbatimit të projektit.

2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga Ministria e Financave, me kod 201, shuma prej 1,375,726.22€ (një milion e treqindeshtatëdhjetepesë mijë e shtatëqindenjëzetegjashtë euro e njëzetedy centë), nga nënprogrami "Huamarrja për projekte potenciale brenda MFPT", me kod 48900, nga kategoria e shpenzimeve "Investime kapitale", nga projekti "Kontigjenca për Klauzolë të Investimeve", me kod 15045, nga fondi burimor 06, dhe transferohen në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me kod 210, në nënprogramin "Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore", me kod 60800, në kategorinë e shpenzimeve "Investime kapitale", për projektin "Nxitja dhe Levimi i Mundësive për Sigurinë e Ujit", me kod 19076, burimi i financimit të huamarrjes "Klauzola e Investimeve 06".

3. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 30, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/1-007, të nenit 15, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Komunës së Fushë-Kosovës për transferimin e mjeteve në shumë prej 406,000.00€ (katërqindegjashtë mijë eurosh), përkatësisht transferimi deri në 25% të ndarjes së ndikuar negativisht.

2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga Komuna e Fushë-Kosovës, me kod 612, nga kategoritë e shpenzimeve dhe nënprogrami/projektet si në vijim:

   2.1. Nga nënprogrami "Arsimi fillor, i mesëm i ulët", me kod 93030, merren mjete në shumë prej 406,000.00€ (katërqindegjashtë mijë eurosh), nga kategoria e shpenzimeve "Investime kapitale", që përbëjnë 23.7% të ndarjes së ndikuar negativisht, nga projektet kapitale si në vijim:

   2.1.1. "Renovimi i objekteve shkollore, shkollat: B. Curri, M. Grameno, M. Grameno II, D. Bogujevci, V. Frashëri, Z. Salihu dhe H. Sulejmani", me kod 20867, në shumë prej 200,000.00€ (dyqind mijë eurosh), nga fondi burimor 10.
   2.1.2. "Renovimi i objekteve shkollore, shkollat: B. Curri, M. Grameno, M. Grameno II, D. Bogujevci, V. Frashëri, Z. Salihu dhe H. Sulejmani", me kod 20867, në shumë prej 56,000.00€ (pesëdhjetegjashtë mijë eurosh), nga fondi burimor 21.
   2.1.3. "Blerja e pajisjeve për shkollat fillore në Fushë-Kosovë", me kod 20854, në shumë prej 100,000.00€ (njëqind mijë eurosh), nga fondi burimor 10.
   2.1.4. "Blerja e pajisjeve për shkollat fillore në Fushë-Kosovë", me kod 20854, në shumë prej 50,000.00€ (pesëdhjetë mijë eurosh), nga fondi burimor 21.

3. Mjetet nga pika 2. e këtij Vendimi transferohen në Komunën e Fushë-Kosovës, me kod 612, në nënprogramin dhe kategorinë e shpenzimeve si në vijim:

   3.1. Në nënprogramin "Arsimi fillor, i mesëm i ulët", me kod 93030, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe shërbime", në shumë prej 300.000,00€ (treqind mijë eurosh), nga fondi burimor 10.

3.2. Në nënprogramin "Arsimi fillor, i mesëm i ulët", me kod 93030, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe shërbime", në shumë prej 106,000.00€ (njëqindegjashtë mijë eurosh), nga fondi burimor 21.

4. Obligohen Ministria e Financave dhe Komuna e Fushë-Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 22, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, Vendimit të Qeverisë 13/19, të datës 14.07.2021, lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Vendimin Nr. 12/31, të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49, të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62, të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90, datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 31/99, të datës 30.09.2022, Vendimin Nr. 20/140, të datës 26.04.2024, Vendimin Nr. 23/159, të datës 13.09.2023, Vendimin Nr. 02/270, të datës 07.10.2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e Masës 3.8 - Bursa e Mobilitetit për Studentë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

2. Autorizohet Ministri i Arsimit dhe Shkencës që me Vendim të veçantë t'i përcaktojë kushtet dhe kriteret e përfitimit për masën nga pika 1. e këtij Vendimi.

3. Mjetet e nevojshme për zbatimin e masës nga pika 1. e këtij Vendimi do të ndahen përmes një Vendimi të veçantë.

4. Obligohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/11
Datë: 16.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Identifikimin Elektronik, Shërbimet e Besuara dhe Kuletën e Identitetit Digjital.

2. Obligohen Ministria e Digjitalizimit dhe e Administratës Publike dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.